



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241631

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589568

Në çështjen juridike të :

**AC-I-23-0158-A0001**

*Paditësi*

**H Z J** me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin **B I**, Prishtinë

**Kundër:**

*E paditura/Ankuese*

**N.SH. “Magjistrala”**, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1875, të datës 23 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1875, i datës 23 shkurt 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 10 korrik 2013, në DHPGJS-së ishte parashtruar një padi grupore prej 142 punëtorëve ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit të së paditurës N.SH “Magjistrala” (në likuidim), me të cilat vendime ishin refuzuar kërkesat e punëtorëve të parashtruara para Autoritetit të Likuidimit, e cila lëndë kishte numrin C-IV-13-1216 por që me urdhrin e lëshuar nga gjyqtari i çështjes i DHPGJS-së, i datës 27 nëntor 2013, për ndarjen e padisë, kjo çështje kishte marrë numrin C-IV-15-1875.

Me datë 30 shtator 2015, paditësi kishte parashtruar një parashtresë për rregullimin dhe plotësimin e padisë në DHPGJS kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0045 të datës 31 maj 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për 13 paga të papaguara në shumën prej 4,353.44 euro ishte refuzuar si e papranueshme për faktin se në bazë të informacioneve të dhëna nga Banka Ekonomike mbi historikun e llogarisë së klientit për periudhën janar 2006 deri në dhjetor 2007 na të cilat rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk figuron në listë pagesat e N.SH-së si një i punësuar i saj. Gjithashtu edhe nga dokumentacioni i nxjerrë nga arkiva e N.SH-së ishte vërtetuar fakti se parashtruesi i kërkesës nuk figuron si një i punësuar pranë N.SH-së.

Në ankesë theksohet se e paditura nuk e kishte kontestuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënie të rregullt dhe të përhershme të punës në ndërmarrjen në fjalë e kjo sigurisht për arsye se ekziston dokumentacion i mjaftueshëm i cili dëshmon se paditësi ishte në punë te e paditura dhe kjo e fundit ishte e obliguar t’i paguante atij të gjitha pagat e papaguara deri në ditën e privatizimit të N.SH-së. Tutje, paditësi thekson se nuk është Banka Ekonomike institucioni që i lëshon dhe ruan-mban listat e pagave të punëtorëve, prandaj llogaritë bankare të paditësve dhe historiku i tyre dëshmon vetëm pagesat e bëra nga N.SH-ja paditësit. Pikërisht nga lista e pagave shihet se paditësit i ka mbetur borxh N.SH-ja dhe kjo dëshmohet nga lista e pagave mujore duke filluar nga muaji janar 2006- deri në dhjetor 2007, të cilat lista specifikojnë në mënyrë të qartë titullarin dhe lartësinë e pagës. Gjithashtu, paditësi thekson se i njëjti është në listën e 20% që tregon se ai ishte i regjistruar në N.SH si punëtor aktiv deri në ditën e privatizimit. Provat dhe dokumentacionin lidhur me marrëdhënien e punës në ndërmarrjen në fjalë sipas Ligjit të AKP-së është i detyruar t’i mbaj dhe ruaj punëdhënësi (e paditura) që parashihet me nenin 5.5 të Politikave Operacionale të AKP-së. Andaj, gjykatës i kishte propozuar që të miratohet padia e paditësit dhe të anulohet vendimi i të paditurës, ashtu që AKP t’i paguaj paditësit në emër të

pagave të papaguara shumë prej 4,353.44 euro, kamatën e bazuar në ligj-kamatë për vonesë në shkallën prej 3.5 % që rrjedh nga data 1 janar 2008 deri më 19 dhjetor 2012 dhe kamatën prej 8% nga kjo datë deri në ditën e pagesës së plotë si dhe shpenzimet e përfaqësimit dhe të tjera deri në fund të procedurës.

Paditësi i kishte bashkëngjitur këto prova: autorizimin për përfaqësim, kopjen e letërnjoftimit si dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0045 të datës 31 maj 2013.

Me datë 14 shkurt 2020, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën thekson se ankesa është absolutisht e papranueshme dhe si e tillë nuk duhet konsideruar aspak nga gjykata. Lidhur me kamuflimin e ankesës si “Parashtresë për rregullimin dhe plotësimin e padisë”, pala kundërshtarë konsideron se kjo përbën një praktikë shumë negative lidhur me respektimin e procedurës ligjore që ligji parashikon për ankimimin e vendimeve të Autoritetit të Likuidimit dhe si e tillë është tërësisht e papranueshme. AL në ushtrim të përgjegjësive të veta për trajtimin e kërkesave kreditore të ish punëtorëve të ndërmarrjes ka kërkuar së pari prej parashtruesve e pastaj edhe në burime tjera prova për përcaktimin e të drejtës së gjithsecilit për kompensim për paga të papaguara. AL në bazë të provave të mbledhura ka përcaktuar se një grup ish punëtorësh ka raportuar rregullisht në ndërmarrje, kanë kryer punët e caktuara për të cilat janë paguar e nëse nuk janë paguar, AL u ka njohur të drejtën për pagesën e pjesës së mbetur. Asesi nuk mund të vlerësohet i drejtë përfitimi i pagave nga ata ish punëtorë që nuk kanë raportuar në punë e nuk kanë kryer asnjë detyrë. Në radhë të parë kjo do të përbënte padrejtësi ndaj grupit të punëtorëve që kanë punuar e janë paguar për punën e kryer. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë, e paditura kishte propozuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e papranueshme dhe të vërtetohet vendimi i AL-së. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0045 të datës 31 maj 2013, një fletëkthesë të datës 5 qershor 2013 si dhe një vendim për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 30 shtator 2019.

Me datë 20 qershor 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin duke kërkuar nga i njëjti që të parashtroj prova shtesë në mbështetje të ankesës së tij.

Me datë 8 korrik 2022, paditësi kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e lartcekur të gjykatës, e të cilës përgjigje i kishte bashkëngjitur këto prova: kopjen e librezës së punës, përmbledhjen mujore të rrogave të punëtorëve të SHA “Magjistrala” për muajt janar-dhjetor 2006 dhe janar 2007, një parashtresë të N.SH SHA “Magjistrala” të datës 16 korrik 2007, deklaratë nën betim e Sh P dhe A K, kopjet e letërnjoftimit të Sh P dhe A K, një referencë nga N.SH për Sh P, një kontratë pune

ndërmjet paditësit dhe të paditurës, një Aktvendim i datës 21 qershor 2007 nr. 1088, si dhe regjistrin e punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjatë punës në ndërmarrje.

Me datë 27 korrik 2022, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në të cilën kishte theksuar se kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet si e pabazuar. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0045 të datës 31 maj 2013 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 23 shkurt 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1875 kishte aprovuar plotësisht si të bazuar ankesën e paditësit dhe kishte ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit, ashtu që kishte obliguar të paditurën që ankuesit në emër të kompensimit për 13 paga të papaguara për periudhë janar 2006-janar 2007 t'i paguaj shumën prej 4,353.44 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore t'ia paguaj shumën prej 435.34 euro. Gjithashtu, kishte obliguar të paditurën që ankuesit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i ndërmarrjes në fjalë. Në këtë çështje kontestuese ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesi dhe a i ka mbetur borxh N.SH për periudhën janar 2006-janar 2007. Ankuesi bazën e kërkesës së tij e mbështetë në përmbledhjen mujore të rrogave për periudhën janar 2006-janar 2007, librezën e punës, si dhe deklaratën e dhënë nën betim të ish drejtorit të N.SH-së si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune në N.SH "Magjistrala" për periudhën kohore prej 14 mars 1985 deri më 13 prill 2007, kohë kjo kur ka filluar edhe likuidimi i N.SH-së. Tutje, nga përmbledhjet mujore të rrogave të punëtorëve të N.SH-së të nënshkruara nga llogaritari dhe drejtori i N.SH-së vërtetohet fakti se ankuesi kishte pagë mujore neto në lartësi prej 334.88 euro, gjithsej për periudhën janar 2006-janar 2007 kishte paga borxh në lartësi prej gjithsej 4,353.44 euro. Në deklaratën nën betim të noterizuar ish drejtori i N.SH-së dhe llogaritari kanë deklaruar se me përgjegjësi të plotë morale, penale e materiale se sa i përket çështjes së listës së pagave të përpiluara dhe të nënshkruara tek ndërmarrja në fjalë kanë qenë kompetent, kanë nënshkruar dhe janë të gatshëm të dëshmojnë në çdo kohë dhe te të gjitha institucionet se këto lista të pagave paraqesin gjendjen e saktë të detyrimeve tek të gjitha njësitë e Magjistrales. Andaj, gjykata i kishte pranuar këto si prova relevante dhe të bazuara për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për N.SH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë N.SH i ka mbetur borxh pagat. E paditura në rastin konkret nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për

të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur apo se nuk i ka mbetur borxh pagat ashtu siç përshkruhen në përmbledhjen e rrogave mujore të lëshuara nga drejtori dhe llogaritari.

Me datë 20 mars 2023, AKP-ja kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit të shkallës së parë, C-IV-15-1875 të datës 23 shkurt 2023, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Në ankesë theksohet se N.SH nuk e konsideron një person punëtor aktiv nëse ai nuk e ka vërtetuar se ka punuar pranë ndërmarrjes për periudhën që pretendon kompensim të pagave. AL gjatë shqyrtimit të kërkesës është shërbyer me informacione të brendshme dhe të jashtme dhe në bazë të asaj se çka ka arritur të vërtetohet e ka refuzuar kërkesën. Në këtë rast AL ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike mbi historikun e llogarisë së klientit për periudhën janar 2006-janar 2007 nga të cilat rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk figuron në listën e pagesave të N.SH-së si një i punësuar i saj. AL konsideron se gjykata ka ngatërruar çështje të rëndësishme faktike e rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasojë ka bërë vlerësim të gabuar dhe ka marrë aktgjykim të padrejtë. Autoriteti i Likuidimit rithekson edhe njëherë se parashtruesi nuk saktëson se cili nen i Ligjit për AKP është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit duke shkelur nenin 70.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon që ankesa “duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për AKP-në. Andaj, Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t’i zbatoj ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit, Aktgjykimin e ankimuar si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit

Me datë 11 janar 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën i propozon Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të refuzohet si e pabazuar ankesa e ankueses, ndërsa të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në shumë prej 208.00 euro.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e 13 pagave të papaguara për periudhën janar 2006-janar 2007 në shumën prej 4,353.44 euro nga N.SH. "Magjistrala", ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se në bazë të së dhënave nga Banka Ekonomike mbi historikun e llogarisë së klientit si dhe dokumentacioni i nxjerrë nga arkivi i N.SH-së, Autoriteti i Likuidimit kishte vlerësuar se paditësi nuk ka ofruar shërbime për N.SH-në.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur provat si në vijim: kopjen e librezës së punës, përmbledhjen mujore të rrogave të punëtorëve të SHA "Magjistrala" për muajt janar-dhjetor 2006 dhe janar 2007, një parashtrësë të N.SH SHA "Magjistrala" të datës 16 korrik 2007, deklaratë nën betim e Sh P dhe A K, kopjet e letërnjoftimit të Sh P dhe A K, një referencë nga N.SH për Sh P, një kontratë pune ndërmjet paditësit dhe të paditurës, një Aktvendim i datës 21 qershor 2007 nr. 1088, si dhe regjistrin e punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjatë punës në ndërmarrje.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim të 13 pagave të papaguara për periudhën janar 2006-janar 2007, në shumën prej 4,353.44 euro me interes ligjor 10% në shumën prej 435.34 euro, me arsyetimin se i njëjti kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit këtë shumë, Gjithashtu kishte detyruar të paditurën që ankuesit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga kopja e librezës së punës së paditësit shihet që i njëjti ka ofruar shërbime për N.SH deri në ditën e privatizimit të saj dhe atë me datë 13 prill 2007, ditë kjo kur edhe i ishte mbyllur librezja e punës.

Provë relevante në këtë rast ishin edhe përmbledhjet mujore të rrogave të punëtorëve të SHA “Magjistrala” për muajt janar 2006 deri në janar 2007, nga të cilat kishte rezultuar se N.SH i kishte mbetur borxh paditësit shumën e përgjithshme prej 4,353.44 euro.

Tutje, sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se ashtu siç me të drejtë thekson shkalla e parë, e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësi nuk kishte ofruar shërbime punë për N.SH apo se N.SH nuk i ka mbetur borxh shumën e pagave të papaguara që paditësi e pretendon.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim të 13 pagave të papaguara për periudhën janar 2006-janar 2007 në shumën prej 4,353.44 euro bashkë me interes ligjor prej 10% në shumën prej 435.34 euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumën prej 124.00 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 5 maj 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_